

TESTI PROFESIONAL

E DREJTA PENALE

TEZA 13

I. Pyetje mbi koncepte (9 pikë)

Tentativa e pamundur, përmbajtja, alternativa e paraqitjes (rasteve) dhe dënueshmëria e saj.

Kodi ynë Penal, në nenin 23, parashikon që tentativa për krimet është e dënueshme, me kushtin që personi të ndërmarrë veprime apo mosveprime të drejtpërdrejta, të cilat duhet të jenë të mjaftueshme dhe/apo të domosdoshme, për kryerjen e tyre, por krimi nuk realizohet për rrethana të pavarura nga vullneti i autorit (neni 22 i Kodit Penal).

Ndryshe nga rasti i mësipërm, në rastin e tentativës së pamundur, kur ajo vërtetohet, është e padënueshme, përveç rastit përjashtimor të verifikimit të probabilitetin minimal për ardhjen e pasojës.

Do të jemi përpara tentativës së pamundur, në rastin kur (1) personi përdor mjete jo të përshtatshme për të arritur qëllimin e synuar (e quajtur ndryshe nga doktrina si tentativë me mjete të papërshtatshme) apo (2) sjellja e tij i drejtohet një objekti material të munguar apo të pamundur, çka e bën objektivist të pamundur arritjen e pasojës së dëshiruar (e quajtur nga doktrina si tentativë me objekt të papërshtatshëm).

Në rastin kur personi përdor mjete të papërshtatshme për kryerjen e krimit të dëshiruar, cilësia e mjeteve është e tillë që në asnjë rrethanë nuk mund të sjellë pasojën e dëshiruar nga autori. Këtu mund të përmendim rastin kur tentohet të vritet një person duke e qëlluar me pistoletë, por ajo nuk ka fishekë; apo tentohet të shkaktohet vdekja e personit duke përdorur një sasi të vogël helmi, që nuk mund të sjellë humbjen e jetës.

Ndërkohë, në rastin e tentativës së pamundur për shkak të mungesës së objektit material apo të pamundësisë së ekzistencës së tij, si raste mund të përmendim kur autori tenton të vrasë një person duke goditur me armë në një vend ku nuk ka njeri apo rastin kur një person që kërkon të kryejë një akt terrorist hedh një bombë në një kazermë ushtrie që ka kohë që qëndron e braktisur.

Sikundër e theksuam edhe më lart, tentativa e pamundur është çmuar nga ligjvënësi që të jetë e padënueshme, pasi ardhja e pasojës është absolutisht dhe objektivist e pamundur, me gjithë dëshirën dhe vullnetin e autorit për ta arritur atë. Nëse sjellja e personit nuk është në gjendje të shkaktojë asnjë lloj cenimi apo rrezikimi të të mirës juridike, apo objekti material mbi të cilin janë drejtuar veprimet e personit nuk ekziston, nuk do të ishte e logjikshme dhe as e ligjshme që personi të dënohej penalisht.

Gjithsesi, në qoftë se deri në momentin e kryerjes së veprimeve që kanë formuar tentativën e pamundur, janë kryer vepra penale të tjera, p.sh. në rastin e hedhjes së bombës në kazermën ushtarake të braktisur, personi do të mbajë përgjegjësi penale për mbajtje pa leje të armëve plasëse, sipas nenit 278 të Kodit Penal.

Në rastin kur nuk ka përgjegjësi penale, ligjvënësi ka vlerësuar rrethanën objektive, pasojën. Ndërsa, kur ka përgjegjësi penale vlerëson rrezikun e mundshëm, nisur nga vendosmëria e personit, mjetet e përdorura dhe rastësisë që objekti është i pamundur të cenohet.

II. Pyetje krahasuese (10 pikë)

Dallimet dhe elementet e përbashkëta që përmbajnë veprat penale të “heqjes së paligjshme të lirisë”, neni 110 i Kodit Penal, në raport me veprën penale të “rërëmbimit”, neni 109 i Kodit Penal.

Dallimet dhe elementet e përbashkëta që përmbajnë veprat penale të “Heqjes së paligjshme të lirisë” (neni 110 i Kodit Penal) dhe “Rrëmbimit apo mbajtjes peng të personit” (neni 109 i Kodit Penal) janë përcaktuar nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin e tyre unifikues nr. 1, datë 25 mars 2005.

a) Të përbashkët e këtyre veprave penale mund të përmbliidhen, si më poshtë:

Për sa i përket objektit, veprat penale “Heqja e paligjshme e lirisë” dhe “Rrëmbimi apo mbajtja peng e personit”, marrin në mbrojtje të përgjithshme lirinë e personit kundrejt çdo lloj privimi të saj, dhunimit dhe nënshtrimit të detyrueshëm fizik nga cilido, veprime këto që nuk janë të autorizuara apo lejuara nga ligji.

Këto vepra kanë anë objektive thujse të njëjtë. Sjellja dhe veprimet e autorit, sipas nenit 109 të Kodit Penal janë: “rrëmbimi ose mbajtja peng e personit”, që në vetvete nuk janë gjë tjetër veçse veprime që kanë kuptim të njëjtë ose sjellin si pasojë heqjen e paligjshme të lirisë së viktimës. Edhe në rastin e nenit 110, nga pikëpamja e anës objektive, është e nënkuptuar se heqja e paligjshme e lirisë e përmban në vetvete ushtrimin e dhunës, kryerjen e veprimeve të tilla që çojnë në heqjen e lirisë dhe pamundësinë e personit për të “lëvizur” në liri. Këto veprime jo vetëm nuk përjashtojnë, por përfshijnë, si rastet e mbajtjes peng e rrëmbimit të personit, ashtu edhe forma të tjera të privimit të lirisë pa ushtrim dhune fizike.

Këto vepra penale, pavarësisht nga kohëzgjatja, konsiderohen të kryera që në çastin kur vërtetohet koha dhe vendi i realizimit të privimit dhe dhunimit të lirisë së personit, pavarësisht nëse autori ka arritur ose jo të realizojë përfitimet dhe qëllimet e parashikuara në vepër dhe përkundrejt të cilave ai do të liroje viktimën.

b) Dallimet ndërmjet veprat penale të “Heqjes së paligjshme të lirisë” (neni 110 i Kodit Penal) dhe “Rrëmbimit apo mbajtjes peng të personit” mund të përmbliidhen, si vijon:

Dallimi i parë konsiston në të mirën juridikë që këto vepra penale marrin në mbrojtje: Rrëmbimi apo mbajtja peng e personit, edhe pse është e vendosur në seksionin VII “Veprat penale kundër lirisë së personit”, ka për objekt jo thjesht mbrojtjen e lirisë personale (e përbashkët me heqjen e paligjshme të lirisë), por edhe paprekshmërinë dhe mbrojtjen e pasurisë.

Amun Kaldesi

Nga ana objektive, në dallim nga rrëmbimi, te heqja e paligjshme e lirisë nuk përjashtohet kryerja e saj nëpërmjet mosveprimeve të personave që kanë në ngarkim apo janë ngarkuar me detyra për mbrojtjen dhe garantimin e lirisë individuale të viktimës.

Heqja e paligjshme e lirisë, nga pikëpamja e anës subjektive, realizohet për qëllime dhe motive që nuk janë nga ato të përfshira në përmbajtjen e nenit 109 të Kodit Penal (qëllimi i përfitimit dhe lirimi i viktimës përkundrajt realizimit të këtij qëllimi, përbejnë në mënyrë të njëkohshme elemente thelbësore të kësaj vepre penale të rrëmbimit), pavarësisht nëse janë a pretendohen të jenë të drejta a të ligjshme dhe pavarësisht nëse ato janë me natyrë pasurore, materiale ose të një natyre a marrëdhënie tjetër që nuk kualifikohen si të tilla. Ndërkohë, heqja e paligjshme e lirisë nuk i ka të përcaktuara motivet në kuptim të anës subjektive, gjë që do të thotë se ato janë të tilla që nuk përfshihen në nenin 109 ose në vepra të tjera penale.

III. Pyetje argumentuese (13 pikë)

Argumentoni situatën nëse akuzat e ngritura nga prokurori do të jenë të suksesshme në gjykim, kur ai, prokurori, ka akuzuar për vrasje, sipas nenit 78 të Kodit Penal, dhe për tentativë vrasje, sipas nenit 78-22 të Kodit Penal, një të pandehur që, më parë ka tentuar të vrasë viktimën, nuk ia ka arritur qëllimit dhe, menjëherë pasi ka shënjestruar më mirë, e ka vrarë atë.

Në rastin konkret, gjykata do ta deklarojë fajtor autorin/të pandehurin vetëm për kryerjen e krimit të "Vrasjes me paramendim", sipas nenit 78 të Kodit Penal. Në vendimin e saj përfundimtar, gjykata do t'i japë faktit penal një kualifikim të ndryshëm, vetëm si vrasje me paramendim, parashikuar nga neni 78 i Kodit Penal (vetëm një herë), ndryshe nga akuza e bërë nga prokurori.

Në rastin në shqyrtim, edhe pse autori nuk ka arritur të shkaktojë menjëherë pasojën e dëshiruar (vrasjen e viktimës), pasi me veprimin e parë ai nuk ka arritur ta qëllojë viktimën për shkak të pavarura prej tij (mungesë shënjestre), ai menjëherë më pas dhe aty për aty ka arritur ta realizojë qëllimin kriminal, duke i shkaktuar vdekjen viktimës.

Në këtë kazus nuk mund të ketë vend copëzimi i faktit penal, fillimisht si tentativë vrasje me paramendim (neni 78-22) dhe më pas si vrasje me paramendim (neni 78), pasi jemi përpara veprimeve të pashkëputura në kohë të autorit, të kryera në mënyrë simultane, me qëllimin përcaktues, të planifikuar dhe të dëshiruar, marrjen e jetës së viktimës.

Në këtë rast, edhe pse në dukje, krijohet përshtypja që jemi përpara konkurrimit ideal të veprave penale, pasi krimi i parashikuar nga neni 78 i Kodit Penal duket sikur është kryer dy herë, fakti që jemi përpara unitetit të veprimeve të drejtpërdrejta dhe të domosdoshme për ardhjen e pasojës, të kryera në të njëjtin vend dhe brenda një harku kohor shumë të shkurtër, të çojnë në përfundim ligjor që veprimet e të pandehurit duhen cilësuar vetëm si vrasje me paramendim. Të gjithë veprimet e mëparshme, përfshirë edhe tentativën e parë, edhe pse paraqesin rrezikshmëri shoqërore, nuk janë të krahasueshme me rrezikshmërinë që tregon vrasja me paramendim e viktimës, ndaj kjo e fundit (neni 78) i përthith veprimet e tjera, përfshi edhe tentativën paraprijëse të autorit të veprës penale, duke e kualifikuar faktin penal vetëm një herë.

Amun Bekteshi

Do të ishim përpara këtij kualifikimi të bërë nga organi i akuzës vetëm nëse veprimet e tentimit të vrasjes dhe më pas vrasjes së të njëjtës viktimë do të ishin të shkëputura në kohë, pra ndërmjet secilit veprim të ketë kaluar një kohë e matshme, që nuk vërehet në rastin në gjykim, ku autori, në një çast kohor të shkurtër, kreu një pas një veprime të drejtpërdrejta, fillimisht jo të afta për të arritur pasojën e dëshiruar, sipas një plani të mirëmbuar dhe me gjakftohtësi.

IV. Arsyetim analitik (18 pikë)

Analizoni situatën kur, një person akuzohet sipas nenit 284/a të Kodit Penal, "Organizimi dhe drejtimi i organizatës kriminale", ngaqë ka kryer veprën në mënyrën e shënuar në paragrafin që thotë: "...krijimi... i lehtësirave nga persona me funksione shtetërore..." Çfarë opinioni do të mbështesni për të dalluar që personi që ka vepruar sipas kësaj mënyre është apo jo bashkëpunëtor në kryerjen e veprës penale dhe nuk është në rolin e bashkëpunëtorit të zakonshëm?

Në nenin 284/a të Kodit Penal është parashikuar një formë e veçantë e organizatës kriminale, krahas atyre të parashikuara në nenin 28, që i dedikohet krimeve të lidhura me narkotikët dhe që përfshin e dënon vetëm organizatorët, d.m.th. personat që e kanë krijuar këtë organizatë, e drejtojnë dhe koordinojnë veprimtarinë kriminale të saj, si dhe financojnë aktivitetin e paligjshëm.

Në paragrafin e dytë të nenit 284/a është parashikuar sjellja e ndëshkueshme e personave që ushtrojnë funksione shtetërore dhe që i japin ndihmë rastësore kësaj organizate dhe pa qenë në dijeni të ekzistencës së saj, nëpërmjet krijimit të kushteve dhe/apo lehtësirave për të arritur qëllimin kriminal për të cilën është krijuar kjo organizatë - sigurimin e përfitimeve ekonomike nga tregtimi kombëtar apo ndërkombëtar i lëndës narkotike.

Nga përmbajtja e kësaj dispozite arrihet në përfundimin se, në këtë rast funksionari shtetëror e ofron vetëm një herë ndihmën e tij ndaj personave të caktuar të organizatës pa pasur dijeni për ekzistencën e saj, personat që bëjnë pjesë në të dhe veprimeve të kundërligjshme që ka kryer ajo. Në këtë rast zyrtari është në pamundësi për të kuptuar se, ndihma që po jep ka lehtësuar një aktivitet kriminal që kryhet nga një grup personash si dhe është në pamundësi të njohë anëtarët e organizatës. E thënë me fjalë të tjera, veprimet e funksionarit shtetëror, edhe pse e ndihmojnë organizatën në një aspekt të caktuar dhe të shkëputur të aktivitetit të saj, kjo ndihmë ofrohet "së jashtmi", pa pasur dijeni për organizatën kriminale. Për këtë qëllim, legjislatori e ka shkëputur funksionarin shtetëror nga pjesa drejtuese e organizatës, të përmendur në paragrafin e parë, të nenit 284/a të Kodit Penal, si dhe nuk e ka përfshirë atë si pjesë e saj (anëtarësinë në të). Në këtë rol që i ka njohur dispozita në fjalë, funksionari shtetëror nuk është bashkëpunëtor në organizatë (drejtues dhe pjesëmarrës).

Në të kundërt, nëse në gjykim provohet që funksionari shtetëror ka dijeni për organizatën kriminale dhe pjesëtarët e saj dhe i ofron ndihmën e tij, duke shpërdoruar funksionin publik të caktuar qoftë edhe në një rast apo për më tepër, vendos një bashkëpunim të qëndrueshëm me këtë organizatë, në këtë rast funksionari shtetëror është pjesë e organizatës, (në rol organizues për një pjesë të veprimtarisë) pasi veprimet e tij jo vetëm mundësojnë kryerjen e veprimtarisë së

Amour Klokoli

organizatës pa pengesa, por ato kryhen në përmbushje të qëllimeve që ka organizata kriminale. Po kështu, edhe kur, funksionari shtetëror vijon lehtësimin për herë të dytë apo ka mundësi të kuptojë që lloji i aktivitetit është i atillë që nuk mund të kryhet nga një person i vetëm, ai do të vlerësohet si bashkëpunëtor.

Rrjedhimisht, sjellja e funksionarit duhet kualifikuar sipas paragrafit të parë të nenit 284/a, duke iu aplikuar ndaj tij edhe rrethana rënduese e “shpërdorimit të funksionit publik”, parashikuar nga neni 50, shkronja “dh” i Kodit Penal.

